



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21.5.2023

Nr: 543

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 21.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 4 (katër) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 21, ZAZ nr. 22, ZAZ nr. 23 dhe ZAZ nr. 24.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Durrës.

Data: 21.5.2023 Nr: 543
Ora: 12:30



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimi dhe nxjerrja e rezultatit të votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 22, ZAZ nr. 23 dhe KZAZ nr. 24, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Durrës dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Durrës, u kontrolluan Tabelat Përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 21, ZAZ nr. 22, ZAZ nr. 23, ZAZ nr. 24, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu dhe për këshillin, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të çdo QV-je të zonës përkatëse, përveç rezultatit të QV-së nr. 1467/03 në ZAZ-në nr. 22, që me vendim të KZAZ-së nr. 22, kutia me fletë votimi për këshillin është shpallur kuti e parregullt.

Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës dhe Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, miratohet me vendim nga KQZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të znj. Emiriana Sako si Kryetar i Bashkisë Durrës, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Durrës, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË



BASHKIA DURRËS, QARKU DURRËS

Lidhja 1

		ZAZ 21	ZAZ 22	ZAZ 23	ZAZ 24	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	80.154	68.843	58.242	58.625	265.864
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	27.099	23.290	20.011	19.471	89.871
3	Vota të pavlefshme	700	619	588	566	2.473
4	Vota të vlefshme	26.369	22.641	19.412	18.874	87.296
5	Fletë votimi të hedhura gabim	30	30	11	31	102
1	Igli Latif Cara	11.410	10.171	8.990	8.213	38.784
2	Emiriana Hiqmet Sako	14.959	12.470	10.422	10.661	48.512
	Totali i votave të vlefshme	26.369	22.641	19.412	18.874	87.296

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË
BASHKIA DURRËS, QARKU DURRËS



Lidhja 2

		ZAZ 21	ZAZ 22	ZAZ 23	ZAZ 24	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	80.154	68.843	58.242	58.625	265.864
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	27.108	23.035	20.018	19.487	89.648
3	Vota të pavlefshme	1.004	651	691	427	2.773
4	Vota të vlefshme	26.063	22.350	19.315	19.029	86.757
5	Fletë votimi të hedhura gabim	41	34	14	31	120
1	Bashkë Fitojmë	6.917	5.248	4.639	4.482	21.286
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	13.132	11.480	9.684	9.565	43.861
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	1.053	1.086	1.476	1.763	5.378
4	Partia Republikane Shqiptare	191	95	203	142	631
5	Partia Levizja e Legalitetit	139	137	31	40	347
6	Partia Demokracia Sociale	97	120	110	77	404
7	Aleanca Liberale e Djathtë	219	199	150	95	663
8	Partia Socialdemokrate	1.251	491	204	397	2.343
9	Partia Demokratike	2.384	2.397	1.718	1.612	8.111
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	97	76	262	96	531
11	Fryma e Re Demokratike	216	191	140	95	642
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	223	709	474	405	1.811
18	Partia Balli Kombëtar	43	26	28	42	139
40	Ardhmëria Shqiptare	101	95	196	218	610
	Totali i votave të vlefshme	26063	22350	19315	19029	86757

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI